



RREGULLORE MËSIMORE E PROGRAMIN TË STUDIMIT

BACHELOR

NË

INXHINIERI TELEKOMUNIKACIONI



I. Të përgjithshme

Rregullorja mësimore e programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni, mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “ Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në akte të tjera nënligjore për arsimin e lartë, në Statutin e UPT, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Rregulloren e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Rregulloren e Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit.

Neni 1

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni është pjesë e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit i cili është krijuar në dhjetor 2007 bazuar në VKM Nr. 824, datë 05.12.2007 për “Krijimin e disa njësive kryesore, fakultete, në Universitetin Politeknik të Tiranës”.

Neni 2

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni ka për qëllim dhënien e njohurive të reja, për t’i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike për plotësimin e nevojave të tregut të punës, lidhur me fushat e Inxhinierisë Telekomunikacioni dhe të fushave të ngjajshme.

Neni 3

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni është një program studimi i ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, i cili mbulohet nga Departamenti të Elektronikës dhe Telekomunikacionit.

Neni 4

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

II. Organizimi

Neni 5

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni realizohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT, 2019, Rregulloren e brendëshme të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe drejtohet nga Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 6



Detyrat e Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit janë:

- Paraqitja e programit të studimit për miratim në Dekanatin e FTI-së dhe Senatit e UPT
- Përgatitja e planit mësimor
- Rishikimi i programeve mësimore
- Hartimi i strukturës mësimore
- Menaxhimi i të gjithë aktiviteteve mbështetëse për mbarëvajtjen e programit të studimit

Neni 7

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni organizohet pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, në korpusin universitar UPT, Sheshi “Nënë Tereza”, si dhe pranë laboratorëve të Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit.

Neni 8

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni kryen të gjitha regjistrimet e veta nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

III. Pranimi i kandidatëve

Neni 9

Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni regjistrohen persona sipas listave fituese të renditura nga komisioni Ad-Hoc dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

Neni 10

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FTI dhe UPT. Kandidatët regjistrohen sipas procedurave të miratuara nga FTI.

Neni 11

Regjistrimet në Programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni bëhen në zbatim dhe në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe vendimet e udhëzimet e ministrisë përkatëse. Ato kryehen pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

Neni 12

Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptare ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në statutin e UPT, rregulloren mësimore të UPT dhe rregulloren e brendshme të FTI.



Neni 13

Njohja e krediteve bazohet në Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në Universitetit Politeknik të Tiranës UPT .

IV. Zhvillimi i aktiviteteve

Neni 14

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni zhvillohet me kohë të plotë. Ai zgjat tre vite akademike. Kohëzgjatja maksimale e studimeve nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i ohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe zhvillohen lëndët sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e dytë të vitit të tretë zhvillohet gjithashtu dhe praktika profesionale dhe mbrojtja e diplomës. Diploma është një punim i pavarur i studentit të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike.

Neni 15

Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit *Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni* është gjuha shqipe.

Neni 16

Leksionet do të zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekanati i FTI.

Neni 17

Kontrolli i dijeve në çdo modul bëhet nëpërmjet vlerësimit të detyrave të kursit, pjesmarrjes në laborator dhe provës përfundimtare, provimit.

Neni 18

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve përcaktohet në rregulloren e UPT-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FTI-së.

Neni 19

Rezultatet e frekuentimit, provave përfundimtare të moduleve dhe të mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Fakultetit të Teknologjise së Informacionit.

Neni 20

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajset me diplomë "*Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni*" të firmosur nga Dekani i Fakultetit të Teknologjise së Informacionit dhe nga Rektori i UPT-së.



Miratur me vendim DET, Nr. 4, Datë. 14.02.2020.

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc. Olimpjon Shurdi